




Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



KA/Nr. 2900/20  
Datë: 23/11/2020

Komisioni i Ankesave në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, i themeluar me Vendimin Nr.1448/20D, të datës 04.09.2020, në përbërje të Faton Merovci, Muhamet Qerimi, Krenare Sogojeva Dërmaku, në shqyrtimin e lëndës administrative, respektivisht ankesës së Universitetit të Gjakovës “Fehmi Agani”, nr.prot. 836/20H, e datës 10.07.2020, kundër Vendimit të KSHC nr. ref. 578/20D, i datës 22.06.2020 për refuzimin e kërkesës/aplikacionit për akreditimi/riakreditim të programeve: Mami BSc, 180 ECTS; Infermieri, BSc, 180 ECTS; Fizioterapi BSc, 180 ECTS, e pranuar më datë 23.10.2020, në mbështetje të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr.15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e datës 05.11.2020, me shumicë votash, mori këtë:

#### VENDIM

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e Universitetit të Gjakovës “Fehmi Agani”, nr.prot. 836/20H, e datës 10.07.2020 dhe vërtetohet Vendimi i KSHC-së nr. ref. 578/20D, i datës 22.06.2020.

#### ARSYETIM

Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani”, më datë 10.07.2020, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), përmes së cilës ka atakuar Vendimin e Këshillit Shtetëror i Cilësisë nr. ref. 578/20D, të datës 22.06.2020 për refuzimin e kërkesës/aplikacionit për akreditimi/riakreditim të programeve: Mami BSc, 180 ECTS; Infermieri, BSc, 180 ECTS; Fizioterapi BSc, 180 ECTS, mbi pretendimet se:

Gjatë shqyrtimit të kërkesës për akreditim/riakreditim të programeve: Mami BSc, 180 ECTS; Infermieri, BSc, 180 ECTS; Fizioterapi BSc, 180 ECTS, Këshilli Shtetëror i Cilësisë ka nxjerrë vendim refuzues pasi ka konstatuar se dosjet e stafit akademik, respektivisht kualifikimi i tyre nuk janë në përputhshmëri me fushën e programit të studimeve.

Pala pretendon se KSHC ka vlerësuar gabimisht kur ka vendosur se bartësit e programeve nuk i përkasin fushave përkatëse të programeve, pasi për programin infermieri ka paraqitur tetë (8) persona dhe për programin fizioterapi, pala ka paraqitur gjashtë (6) persona, e për të cilët

pretendon se janë të fushës dhe janë në përputhshmëri me Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr. 15/2018 për akreditim të institucioneve të arsimit të lartë (IAL) dhe me kategorizimin e kualifikimeve sipas Erasmus Subject Area Code. Po ashtu, pala pretendon se me qëllim të përmbushjes së kriterëve që derivojnë nga Udhëzimi (MASHT) Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve ka ndjekur të gjitha procedurat e rekrutimit për përzgjedhjen e stafit akademik dhe se ky staf ka shkëputur marrëdhënien e rregullt të punës me institucionet paraprake për të krijuar marrëdhënie të re në Universitetin e Gjakovës.

#### **Provat e administruara:**

- Vendimi i KSHC-së nr.ref. 578/20D, i datës 22.06.2020;
- Erasmus Subject Area Code;
- Lista e bartësve të programit Infermieri me kualifikimet e tyre (Excel);
- Lista e bartësve të programit Fizioterapi me kualifikimet e tyre (Excel);
- Raporti nga e-akreditimi për Besarta Pelaj, Arta Dalipi dhe Bajram Shyti;
- Raporti i KSHC-së për rishqyrtimin e ankesës të datës 02.09.2020.

#### **Shpjegim i situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi**

Komisioni i Ankesave në AKA, ka pranuar ankesën nr.prot. 836/20, e datës 10.07.2020 të Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani" më datë 23.10.2020, së bashku me dokumentacionin dhe raportin e KSHC-së për rishqyrtimin e ankesës të datës 02.09.2020, me të cilën ka përshkruar pretendimin e palës dhe arsyen e refuzimit të kërkesës për akreditim.

Komisioni i Ankesave, pas shqyrtimit të ankesës dhe provave të bashkëngjitura ka gjetur se:

Universiteti i Gjakovës në ankesën e tij nuk ka paraqitur pretendime për mos akreditim të programit Mami, BSc, 180 ECTS dhe nuk ka atakuar vendimin e KSHC-së për këtë program.

Për programin Infermieri, nga tetë (8) bartës që ka paraqitur Universiteti, vetëm një (1) prej tyre është i fushës së programit të studimeve dhe i njëjti nuk është në marrëdhënie të rregullt pune në këtë Universitet. Respektivisht, Universiteti i Gjakovës për programin Infermieri BSc ka paraqitur si bartës të programit Ramush Bejiqi, dr.pediatri, Ilirijana Raça Bunjaku, Phd në kurse klinike, Qëndresa Qovanaj, MA në menaxhment shëndetësor, Besarta Pelaj, MA në menaxhment shëndetësor, Vanesa Tanushi, MA në menaxhment shëndetësor të institucioneve dhe shërbime, Arta Dalipi, MA në menaxhim në infermieri, Hateme Hoxha, Doktor i mjekësisë, Bylbyl Kadria, Doktor i Mjekësisë. KSHC ka vlerësuar se prej tetë (8) personave të prezantuar si bartës, vetëm Arta Dalipi, me drejtimin menaxhim në infermieri, plotëson kriterin për të qenë bartës e programit dhe e njëjta nuk është në marrëdhënie të rregullt pune në këtë Universitet.

Për programin Fizioterapi, nga gjashtë (6) persona të paraqitur si bartës, vetëm dy (2) plotësojnë kriteret dhe njëri prej tyre nuk është në marrëdhënie të rregullt të punës në këtë Universitet. Respektivisht, Arben Boshnjaku, MA në Fizioterapi, Idriz Berisha, PhD në shkencë mjekësore, Edita Cufaj Kadria, MA në edukim për kujdesin shëndetësor, Skender Ukaj, MA në shkencë mjekësore, Kushtrim Grezda, Doktor i mjekësisë, Bajram Shyti, Msc. në Fizioterapi janë profesorët e prezantuar nga Universiteti si bartës të programit. KSHC ka vlerësuar se vetëm Arben Boshnjaku dhe Bajram Shyti i përkasin fushës së programit të studimit. Po ashtu Bajram Shyti nuk ka pasur marrëdhënie të rregullt pune në këtë Universitet.

### **Shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave**

Komisioni i Ankesave, pasi ka konstatuar se ankesa është parashtruar brenda afatit kohor, ka shqyrtuar pretendimet e palës për mos-akreditim të programeve, dhe ka gjetur se:

Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani”, për programin Infermieri BSc ka paraqitur si bartës të programit Ramush Bejiqi, dr. Pediatri, Ilirijana Raça Bunjaku, Phd në kurse klinike, Qëndresa Qovanaj, MA në menaxhment shëndetësor, Besarta Pelaj, MA në menaxhment shëndetësor, Vanesa Tanushi, MA në menaxhment shëndetësor të institucioneve dhe shërbime, Arta Dalipi, MA në menaxhim në infermieri, Hateme Hoxha, Doktor i mjekësisë, Bylbyl Kadria, Doktor i mjekësisë. Nga të deklaruarit, sipas provave të administruara (Lista e profesorëve të fushës), vetëm një (1) nga ta është e fushës, respektivisht Arta Dalipi, e që e njëjta është e deklaruar në Kolegjin Heimerer, e vërtetuar përmes e-Akreditimi.

Ndërsa, Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani” për Programin Fizioterapi ka paraqitur gjashtë profesorë: Arben Boshnjaku, MA në Fizioterapi, Idriz Berisha, PhD në shkencë mjekësore, Edita Cufaj Kadria, MA në edukim për kujdesin shëndetësor, Skender Ukaj, MA në shkencë Mjekësore, Kushtrim Grezda, Doktor i mjekësisë, Bajram Shyti, Msc në Fizioterapi. Nga të deklaruarit, sipas provave të administruara (Lista e profesorëve të fushës), vetëm dy (2) nga ta janë të fushës, respektivisht Arben Boshnjaku dhe Bajram Shyti. Nga faqja zyrtare e-akreditimit, dhe provat e ofruara nga vet pala, Bajram Shyti ka qenë në proces të rekrutimit dhe i njëjti është i deklaruar për një institucion tjetër, respektivisht për Kolegjin Rezonanca.

### **Baza ligjore e vendimit dhe arsyeja pse është e zbatueshme në rastin konkret**

Komisioni i Ankesave për programin Infermieri, bazuar në nenin 30 paragrafi 2 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, i cili përcakton se: *” Staf i Akademik i cili ndryshon angazhimin brenda vitit akademik, nuk do të pranohet nga AKA për qëllime të vlerësimit dhe akreditimit”*, ka gjetur se Arta Dalipi është deklaruar në një institucion tjetër dhe kjo është vërtetuar përmes faqes zyrtare të E-akreditimit, e si rrjedhojë programi Infermieri ka mbetur pa asnjë bartës nga fusha e programit të studimeve.

Ndërsa për programin Fizioterapi, bazuar në nenin 26, paragrafin 5.3.4 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL- ve, që përcakton se: *“Për programet e studimit të cilat shprijen deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për një grup të studentëve (të përcaktuar sipas statutit të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit të studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit.”*. Në vazhden e kësaj, neni 26, paragrafi 5.4.5, ka përcaktuar se: *“Nëse programi i studimit përmban edhe specializime atëherë numri i specializimeve duhet të jetë në përputhje me numrin e stafit akademik të rregullt me gradë akademike PhD, në atë program, i cili ka kompetencën e duhur për ato specializime”*. Tutje, UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL- ve në nenin 26, paragrafin 5.3.7, ka përcaktuar se: *“Kërkesat nga pikat 5.3.4. dhe 5.3.5. për titujt e stafit akademik (PhD) nuk do të vlejnjë për programe profesionale të cilat shprijnë deri tek marrja e një diplome profesionale”*.

Nga kjo, Komisioni i Ankesave ka gjetur se katër (4) nga profesorët nuk janë konsideruar si bartës të programit për shkak se nuk plotësojnë kërkesat e parapara me paragrafin 5.3.4., 5.4.5 dhe 5.3.7, ndërsa dy të tjerë që janë të fushës, njëri nga ta nuk ka marrëdhënie të rregullt të punës (Bajram Shyti), i cili ka qenë i deklaruar në Kolegjin Rezonanca. Rrjedhimisht, Programi Fizioterapi ka mbetur vetëm me një bartës me titullin Master të fushës së programit të studimit.


Në përfundim,

Komisioni i Ankesave pasi shqyrtimit dhe administrimit të provave, vërtetimit të gjendjes faktike dhe legjislacionit në fuqi, mbi bazën e kompetencave të dhëna me nenin 22, paragrafin 3 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Komisioni i Ankesave në AKA


KA/Nr. 2900/20, datë 23/11 /2020

Procesmbajtësi



Arianit Krasniqi

Kryetari i Komisionit të Ankesave



Faton Meroyei



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditëve në gjykatën kompetente për konfliktet administrative.